



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.44/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Kymete Kicaj kryesuese, Skënder Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Subjekti Politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Vendimi Nr.01/84-2025 për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht dhe Vendimi Nr.01/85-2025, për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) të datës 14.01.2025 të datës 14.01.2025, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa A.nr.44/2025 e datës 16.01.2025 e parashtruar nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren, të paraqitur ndaj Vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve - Vendimi Nr.01/84-2025, i datës 14.01.2025, për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, dhe vendimit Nr.01/85-2025, i datës 14.01.2025, për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Më datë 16.01.2025, Subjekti Politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), ka parashtruar ankese ndaj vendimit të KQZ-së Nr.01/84-2025 dhe Vendimit Nr. 01/85-2025, në lidhje me shpërndarjen e komisionerëve të vendvotimeve për zgjedhjet që do të mbahen më datë 9 shkurt 2025, në Komunën e Gjilanit, të organizuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me pretendimin se gjatë procesit të fundit në përbërjen e komisionerëve të vendvotimeve, është vërejtur një zvogëlim i jashtëzakonshëm i numrit të komisionerëve në Komunën e Gjilanit, që u caktohen

partive të komuniteteve, të cilat kanë të drejtë përfaqësimi sipas Kushtetutës dhe Ligjit mbi Zgjedhjet, ku besohet në një lëshim teknik nga ana e KQZ-se. Po ashtu parashtruesi i ankesës subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) në ankesë ka potencuar se në të gjitha zgjedhjet e mbajtura në Republikën e Kosovës qofte Parlamentare qofte Lokale ku jemi përfaqësuar si në Parlament ashtu edhe në Kuvendin Komunal të Gjilanit gjithmonë kane qenë numrat e komisionerëve si në Gjilan 128+14 rezerve tani me Vendimin e ri 20+2 rezerve, andaj shpërndarja e komisionerëve në Komunën e Gjilanit nuk është kryer në bazë të kriterëve të drejta. Duhet të theksohet se KDTP është një nga partitë më të vjetra dhe më të themeluara në Kosovë, për këtë duhet të trajtohet në mënyrë barabartë me partitë të tjera të mëdha të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës. Parashtruesi i ankesës thekson se duke marrë parasysh pretendimet e sipërpërmendura ka kërkuar që PZAP, të anulon vendimin me Nr. 01/84-2025 dhe vendimin Nr. 01/85-2025 mbi përbërjen e komisionerëve, duke siguruar që numri i tyre të jetë i drejtë dhe proporcional, në përputhje me ligjet dhe rregullat përkatëse si dhe të sigurojë që partitë e komuniteteve dhe partitë tjera parlamentare të mos dëmtohen, duke garantuar përfaqësim të drejtë në vendvotimeve në Komunën e Gjilanit.

Në përgjigjen në ankesë të datës 17.01.2025 KQZ thekson se ë vendimet e plotfuqishme të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) për A.nr 17/25, A.nr 18/25, A.nr 20/25, A.nr 19/25 të datës 11.01.2025 dhe A.nr 26/25 e datës 13.01.2025 e ka kthyer në rivendosje vendimet e KQZ-së: Vendimi Nr.01/30-2025, i datës 08.01.2025 për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi Nr.01/31-2025, i datës 08.01.2025 i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht. Duke pasur parasysh se vendimet e PZAP-së, janë të detyrueshme për tu zbatuar, KQZ sipas nenit 77 paragrafi 5 i ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në mbledhjen qarkulluese të mbajtur me datën 14.01.2025 ka miratuar përbërjen e Ekipeve të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64 dhe nenin 101 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 20 paragrafi 1 dhe 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit, si dhe neni 3 parafi 1,2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 dhe të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve. Gjatë vendimmarrjes së përbërjes e Ekipeve të Numërimit në QKN-së, KQZ ka marr për bazë nenin 20 paragrafi 1 dhe 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit, si dhe neni 3 parafi 1,2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 dhe të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve si dhe si dhe gjatë vendimmarrjes për përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht ka marr për bazë nenin 64 paragrafi 2.10, nenin 75,76 dhe 77 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 2 paragrafi 2, 3 dhe 4, neni 3 paragrafi 1, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1. dhe 2.2, paragrafi 1,2,3 dhe 4 dhe neni 3 parafi 1,2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve.

Pretendimet e palës ankuese se vendimet e KQZ-së nr.01/85-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN-së dhe vendimi i KQZ-së, nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht janë në Kundërshtim nënin 77 të ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe nenin 20 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit, dhe duke kërkuar nga KQZ të nxjerrë vendim për miratimin e përbërjes së KVV-ve në vendvotimet e rregullta dhe me kusht dhe ti ndaj subjektit politik KDTP në komunën e Gjilanit 128 anëtar të KVV-ve dhe 14 rezerve sikurse në Zgjedhjet e viteve të kaluara. KQZ gjatë rishqyrtimit të vendimit për Përbërjen e KVV-ve në Vendvotimet e rregullta dhe me kusht si dhe emërimin e ekipeve të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit, subjektit politik KDTP i ka shtuar 5 anëtar më shumë në Gjilan, Mitrovicë e Jugut i janë shtuar 7 anëtar dhe 1 rezerve, Prishtinë i janë shtuar 6 anëtar, Prizren i janë shtuar 45 anëtar dhe 2 rezerve. Andaj, pretendimet e palëve ankuese janë të pa bazuara për arsyeje se KQZ, gjatë ndarjes së vendeve në Këshillat e Vendvotimeve është mbështetur në nenin 3 paragrafi 1 Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve, sipas të cilit përfaqësimi në KVV u takon: subjekteve politike të certifikuara të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale. Subjektet Politike të cilat i janë nënshtruar dhe kanë kaluar pragu zgjedhor janë: Lëvizja Vetëvendosje (50.280%) , Partia Demokratike e Kosovës (17.009%), Lidhja Demokratike e Kosovës (12.731%), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (7.124%). Prandaj bazuar në nenin 3 par. 1 të Rregullores Zgjedhore nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve, Përfaqësimi në KVV “KQZ fton subjektet politike të certifikuara të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale që të nominojnë nga 1 anëtar të KVV-ve”. Gjithashtu, KQZ ka vendosur edhe për përfaqësimin në KVV, duke u mbështetur në përkufizimet e nenit 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve parashihet që: ”KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, duke u bazuar në: 2.1. Numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune; 2.2. numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal”. Bazuar në këto nene KQZ ka bërë shpërndarjen e KVV-ve në vendvotimet e rregullta, me kusht dhe ekipet e numërimit në QKN në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore ku ndarja është bere duke trajtuar në mënyre të barabarte subjektet politike në mënyre që kjo përfshirje të reflektoj pjesëmarrjen e barabarte për të gjithë ata qe marrin pjese në procesin zgjedhor. Pretendimi tjetër se subjekti politik KDTP duhet të trajtohet në mënyrë të barabarte me subjektet e mëdha në Kuvendin e Republikës së Kosovës hidhet poshtë për arsye se ky subjekt garon vetëm për vendet e rezervuara sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 64, par. 2, nen paragrafi 2. Përbërja e KVV-ve nga viti 2021 nuk mund të merret si reference për arsye se në vitin 2021 përbërja e KVV-ve është bërë sipas ligjit të vjetër të Zgjedhjeve dhe akteve nënligjore të KQZ-së si dhe në vitin 2021 subjektet e certifikuara për të garuar në zgjedhje kanë qene të ndryshme. Gjatë shqyrtimit të ankesës PZAP duhet të ketë parasysh se mos emërimi i KVV-ve, brenda afateve të përcaktuara rrezikon procesin zgjedhor i cili tani është në fazën e fillimit të trajnimeve të KVV-ve.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës të parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet e palës ankuese se Vendimi Nr.01/85-2025, i datës 14.01.2025 për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi Nr.01/84-2025, i datës 14.01.2025 i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, se vendimet e kontestuar të KQZ-së janë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli i vlerësoj si të pabazuara për faktin se me dispozita ligjore janë përcaktuar qartë përbërjet dhe funksionet e KVV, ku shprehimisht dispozita e nenit 77 par.3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, parasheh se *“Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë”*, ndërsa paragrafi 4 i këtij neni thekson se *“pavarësisht paragrafit paraparak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja, ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KVV-ve, të cilët nuk i përmbushin kushtet sipas këtij neni”*.

Pala ankuese pretendon se sipas vendimit nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht dhe vendimit nr.01/85-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN, për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025, se KQZ-ja, ka bërë lëshim teknik me të cilin është vërejtur një zvogëlim i jashtëzakonshëm i numrit të komisionereve në Komunën e Gjilanit, Paneli i vlerësoj si të pabazuara për faktin se me dispozita ligjore janë përcaktuar qartë përbërjet dhe funksionet e KVV, ku shprehimisht dispozita e nenit 77 par.3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, parasheh se *“Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë”*, ndërsa paragrafi 4 i këtij neni thekson se *“pavarësisht paragrafit paraparak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja, ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KVV-ve, të cilët nuk i përmbushin kushtet sipas këtij neni”*.

Pas verifikimit të provave të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe përgjigjes së KQZ-së, paneli vërtetoi se subjekti politik, KDTP, sipas vendimit nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht dhe vendimit nr.01/85-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN, subjektit politik KDTP i ka të shtuar 5 anëtar më shumë në Gjilan, Mitrovicë e Jugut i janë shtuar 7 anëtar dhe 1 rezerve, Prishtinë i janë shtuar 6 anëtar, Prizren i janë shtuar 45 anëtar dhe 2 rezerve, andaj paneli ka vërtetuar se subjektit ankues i janë; shtuar edhe 5 anëtare; në komunën e Gjilanit (për të cilin është ankuar), që do të thotë se KQZ, ka vepruar konform rekomandimeve të PZAP.

Bazuar në të lartcekurat paneli vlerëson se KQZ ka bërë shpërndarjen e KVV-ve në vendvotimet e rregullta, me kusht dhe ekipet e numërimit në QKN në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore ku ndarja është bere duke trajtuar ne mënyre te barabartë për të gjitha subjektet politike në mënyrë që kjo përfshirje të reflektoj pjesëmarrjen e barabartë për të gjithë ata që marrin pjesë në procesin zgjedhor.

Përfundimisht paneli nga PZAP ka gjetur se KQZ-ja ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjitha subjektet politike, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, si për subjektet që kanë fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet e fundit, e po ashtu edhe për të gjitha subjektet tjera pjesëmarrëse dhe se mbi këtë arsye të njëjtave nuk iu është bërë ndonjë padrejtësi me vendimin nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht dhe vendimin nr.01/85-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN, në këtë kontekst duhet pasur parasysh edhe dispozitën ligjore nenin 77 par.4 të LZP-së e cila i jep të drejtë KQZ-së, për të emëruar anëtarë të KKV sipas zgjedhjes së saj, pa marrë parasysh numrin e votave të fituara në zgjedhjet e fundit.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i refuzuar ankesën si të pabazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr.44/2025, datë 18.01.2025

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.